



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 17
Prishtinë, më 3 qershor 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 3 QERSHOR 2011**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar Kuvendit, kurse i ndihmuan **Xhavit HALITI** dhe **Sabri HAMITI**, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryesuesi **Xhavit Haliti**, deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 66 deputetë. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8, për verërat,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për akcizën në produktet e duhanit,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve,
9. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010,

10. Rekomandimi i Organit Përzgjedhës lidhur me emërimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, dhe
11. Propozimi i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re për emërimin e deputetes Suzan Novoberdaliu, në vend të deputetit Ibrahim Makolli, në Komisionin parlamentar për ndryshimet kushtetuese.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët:

Haki Demolli, Bali Muharremaj, Sali Morina, Nazane Breca, Nait Hasani, Teuta Haxhiu, Afrim Hoti, Ardian Gjini, Liburn Aliu, Bekim Haxhiu, dhe ministri Bedri Hamza, që janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Xhevdet Neziraj, parashtoi pyetje për ministren, Vlora Çitaku, në lidhje me nivelin e përgatitjeve në shkallë vendi, për riatdhesimin e qytetarëve të Kosovës, të cilët gjenden në shtetet e huaja, pa status të zgjidhur.

Ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, iu përgjigj pyetjes së deputetit Neziraj.

Deputeti Agim Kuleta, parashtoi pyetje për kryeministrin, Hashim Thaçi, në lidhje me kodin telefonik të Serbisë, që Kosova vazhdon ta përdorë akoma.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Besim Beqaj, iu përgjigj pyetjes së deputetit Kuleta.

Deputeti Afrim Kasolli, parashtoi pyetje për ministrin, Nenad Rashiq në lidhje me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të punës dhe inspektimin eventual të kompanisë Bchtel&Enka, nga organet kompetente, për të konstatuar gjendjen reale lidhur me shfrytëzimin e fuqisë punëtore nga kjo kompani.

Ministri Rashiq, iu përgjigj pyetjes së deputetit Kasolli.

Deputeti Danush Ademi, parashtoi pyetje për ministrin, Nenad Rashiq, në lidhje me hapat që duhet të ndërmerret Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në lidhje me zgjidhjen e problemit të banimit kolektiv të komunitetit romë, ashkalinj dhe egjiptas, në fshatin Plemetin, komuna e Obiliqit.

Ministri Rashiq, iu përgjigj pyetjes së deputetit Ademi.

Deputetja Afërdita Berisha-Shaqiri, parashtoi pyetje për zv.kryeministren, Mimoza Kusari-Lila, në lidhje me hapat që mund t'i ndërmerret Qeveria e Kosovës ndaj kompanive të cilat i kanë privatizuar ish-ndërmarrjet shoqërore, e të cilat nuk i kanë përmbushur kushtet e parapara me kontratat e shitblerjes.

Zv.kryeministrja Mimoza Kusari-Lila, iu përgjigj pyetjes së deputetes Afërdita Berisha-Shaqiri.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi, parashtoi pyetje për ministrin Bedri Hamza, në lidhje shkeljet eventuale të Ligjit të buxhetit në pozicione të caktuara buxhetore.

Ministri Hamza, iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Deputeti Niazi Idrizi, parashtoi pyetje për ministrin, Fehmi Mujota, në lidhje me kriteret e përdorura nga Ministria e Infrastrukturës, për caktimin e prioriteteve në projektet e propozuara.

Ministri Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Idrizi.

Deputeti Niazi Idrizi, parashtoi pyetje për ministrin, Dardan Gashi, në lidhje me vendndodhjen e ujërave termominerale në vend dhe ndërtimin e infrastrukturës për shfrytëzimin e atyre ujërave.

Ministri Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit Idrizi.

Deputeti Visar Ymeri, parashtoi pyetje për zv.kryeministren, Mimoza Kusari-Lila, në lidhje me atë se çka nënkuptojnë saktësisht masat e reciprocitetit dhe kur do të fillojnë të zbatohen ato.

Zv.kryeministria Mimoza Kusari-Lila, iu përgjigj pyetjes së deputetit Ymeri.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 27 maj 2011

Kuvendi miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare të mbajtur më 27 maj 2011.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 03/I-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/I-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Zëvendëskryeministri **Bujar Bukoshi**, tha se ky projektligj ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/I-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim tha se komunitetet përkufizohen si grupe kombëtare, etnike, kulturore, gjuhësore apo fetare të pranishme në Republikën e Kosovës, siç janë: komuniteti serb, turk, boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran, malazez, dhe komuniteti kroat.

Më tutje zëvendëskryeministri Bujar Bukoshi theksoi se ky projektligj korrespondon me përkushtimin e Qeverisë së Kosovës në raport me komunitetet.

Në fund zëvendëskryeministri Bujar Bukoshi kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/I-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, dhe në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, deputetja, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lumnije Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lirije Kajtazi, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Glauk Konjufca, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Petar

Miletiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetët: Arsim Bajrami, Ardian Gjini dhe zëvendëskryeministri Bujar Bukoshi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,
Kundër-----16,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-047 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8, për verërat

Kryesuesi, **Sabri Hamiti**, ftoi përfaqësuesin e Qeverisë, ta arsyetojë para deputetëve të Kuvendit Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8, për verërat.

Ministri **Blerand Stavileci** tha se ky projektligj vjen si rezultat i moszbatimit të plotë për shkak të mangësive të cilat e kanë shoqëruar Ligjin nr. 02/L-8, për verërat.

Në vazhdim tha se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8, për verërat, ka për qëllim të rregullojë çështjet të cilat kanë të bëjnë me prodhimin, qarkullimin, dhe përpunimin e rrushit për prodhimin e verërave dhe produkteve të tyre.

Më tutje ministri Stavileci theksoi se ky projektligj është në harmoni me legjislacionin e BE-së, nga kjo fushë, ndërsa për projektligjin nuk nevojiten mjete buxhetore shtesë.

Në fund ministri kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8, për verërat.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, deputeti Nait Hasani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Niazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Morina, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Sevdije Lama, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Sasha Millosavljeviq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, si dhe deputetët: Nait Hasani dhe Bekim Haxhiu, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8, për verërat.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme, që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta.

Ministri **Bedri Hamza** tha se Projektligji për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta është hartuar nga ekspertë të ministrisë që ai e drejton dhe nga ekspertë të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, me asistencën e ofruar nga Banka Botërore.

Në vazhdim, ministri tha se deri më tani kjo fushë tek ne ka qenë e rregulluar me Rregullën III për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë, të nxjerrë nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës.

Më tutje, ministri Hamza tha se me këtë projektligj mundësohet krijimi i bazës ligjore për sigurimin e detyrueshëm të autopërgjegjësisë, përcaktimi i kriterëve dhe mekanizmave me anë të të cilëve u ofrohet mbrojtje mbajtësve të polisave të sigurimit dhe palëve të dëmtuara.

Ai më pas vuri në pah se ky projektligj parasheh themelimin e Fondit garantues dhe të Fondit të kompensimit.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Sali Asllanaj, në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar "6+", Rasim Demiri, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palëve të treta.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për akcizën në produktet e duhanit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për akcizën në produktet e duhanit.

Ministri **Bedri Hamza** tha se qëllimi i Projektligjit për akcizën në produktet e duhanit është pagesa e veçantë e akcizës në produktet e duhanit që janë prodhuar, importuar dhe shitur në territorin doganor të Republikës së Kosovës.

Në vazhdim, ministri tha se ky projektligj rregullon marrëdhëniet juridike që kanë të bëjnë me përcaktimin e akcizës në produktet e duhanit, të kushteve, të procedurave, të drejtave dhe detyrimeve që u nënshtrohen tatim paguesit e akcizës, si dhe rregullat për mbledhjen dhe administrimin e taksës së akcizës.

Më tutje, ministri Hamza tha se deri më tani tek ne nuk ka pasur një ligj që do të përcaktonte akcizën në produktet e duhanit dhe çështjeve që ndërlidhen me këtë fushë. Projektligji është në pajtim me legjislacionin e BE-së nga kjo fushë, konstatoi ministri. Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për akcizën në produktet e duhanit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, Safete Hadergjona, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar "Vetëvendosje", Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jelena Bontiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar "6+", Duda Balje, si dhe deputetët: Salihe Mustafa, Haki Demolli, Hydajet Hyseni dhe Bekim Haxhiu, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,
Kundër----- 2,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për akcizën në produktet e duhanit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Projektligjin për përdorim civil të eksplozivëve

Ministri **Bajram Rexhepi** tha se Projektligji për përdorim civil të eksplozivëve adreson çështjet që kanë të bëjnë me kushtet dhe kriteret e prodhimit, tregimit, importit, eksportit transferimit, deponimit, përdorimit dhe asgjësimit të eksplozivëve apo fishekzjarrëve, me qëllim të mbrojtjes së njerëzve, të pasurisë dhe të mjedisit.

Në vazhdim, ministri tha se ky projektligj është harmonizuar me legjislacionin e BE-së nga kjo fushë, ndërsa ka 14 kapituj me gjithsej 56 nene.

Në fund, ai kërkoi miratimin në parim të projektligjit nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për përdorim civil të eksplozivëve.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti, Anton Quni, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Fatmir Xhelili, në emër të Grupit Parlamentar “Vetëvendosje”, Rexhep Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Goran Marinković, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Rasim Demiri, si dhe deputetët: Haki Demolli, Zenun Pajaziti dhe Imri Ahmeti, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 63,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash miratoi, në parim, Projektligjin për përdorim civil të eksplozivëve.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, si komision funksional dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë këtë projektligj në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

9. Shqyrtimi i Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta arsyetojë Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010.

Ministri **Bedri Hamza** tha se ky Raport është hartuar në përputhje me Ligjin për Auditim të Brendshëm nr. 03/L-128.

Në vazhdim, ministri tha se ky Raport prezanton zhvillimet në fushën e auditimit të brendshëm në nivel qendror dhe lokal gjatë vitit 2010.

Më tutje, ministri Hamza u fokusua në të arriturat në fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, disa nga të cilat janë: nxjerrja e udhëzimit administrativ për themelimin dhe funksionimin e komiteteve të auditimit, krijimi i njësive të reja të auditimit, rritja e numrit të auditorëve të brendshëm, trajnimi i tyre, etj.

Në fund, ministri kërkoi miratimin e Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010, nga ana e Kuvendit.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, deputeti Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bali Muharremaj, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari hodhi në votim miratimin e Raportit për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	59,
Kundër-----	2,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin për funksionimin e sistemit të auditimit të brendshëm në sektorin publik të Kosovës, për vitin 2010.

10. Rekomandimi i Organit Përzgjedhës lidhur me emërimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik

Kryetari njoftoi Kuvendin se Organi Përzgjedhës i Pavarur, i emëruar nga Kuvendi i Kosovës, më 19 maj 2011, në mbledhjen e mbajtur më 30 maj 2011, ka shqyrtuar Propozimin e Qeverisë së Kosovës lidhur me emërimin e anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Organi Përzgjedhës i Pavarur i ka rekomanduar Kuvendit, që z. Osman Kryeziu ta emërojë anëtar të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik të Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Propozim-vendim, dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Adem Grabovci, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Myzejane Selmani, që janë dhënë në transkript.

Kryetari hodhi në votim miratimin e Propozim-vendimin për emërimin e z. Osman Kryeziu, anëtar i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 37,
Kundër----- 16,
Abstenime-----15.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

1. Osman KRYEZIU, emërohet anëtar i Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik të Kosovës.
2. Mandati i anëtarit të Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik të Kosovës është pesë (5) vjet.

11. Propozimi Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, për emërimin e deputetes Suzana Novoberdali, në vend të deputetit Ibrahim Makolli, në Komisionin parlamentar për ndryshime kushtetuese

Kryetari njoftoi Kuvendin se Grupi Parlamentar i Koalicionit Kosova e Re ka propozuar deputeten Suzana Novoberdaliu, në vend të deputetit Ibrahim Makolli, në Komisionin për ndryshime kushtetuese. Ai kërkoi nga deputetët që përmes një votimi formal të deklarohen për këtë propozim.

Kuvendi miratoi propozimin e lartpërmendur.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, mori këtë:

V E N D I M

Deputetja Suzana Novoberdaliu, emërohet anëtare e Komisionit për amendamentimin e Kushtetues së Republikës së Kosovës, në vend të deputetit Ibrahim Makolli.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 16:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.